

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 4442 Akt.

V E N D I M
PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date 2-4- 1995, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, M. Hoxha si shqyrtova kerkesen dhe materialet e paraqitura nga Ministria e Financave per regjistrimin e shoqerise tregtare: "Albimpeks Tirane" ne formen e nje shoqerie anonime :

KONSTATOVA SE :

Kerkuesi Ministria e Financave ka paraqitur kerkesen per t'u rregjistruar si person juridik shoqerine ne formen e nje shoqerie anonime "Albimpeks Tirane" me kohezgjatje pa afat te caktuar, me kapital themeltar 209.950.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke me objekt veprimtarie: Eksporti i mallrave industriale ushqimore dhe bimeve mjekesore, import i mallrave ushqimore, lendeve te para, pjese nderrimi dhe linja e objekte per industrine ushqimore.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, Urdher Nr.124, date 12.3.1996 i Ministrise se Financave, kerkese per miratim eksperti jane te plete dhe te bazuar ne ligj dhe si te tille duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare", si dhe nenit 33 ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te".

V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "Albimpeks Tirane" me kohezgjatje pa afat te caktuar me kapital themeltar 209.950.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke dhe me objekt veprimtarie: Eksporti i mallrave industriale ushqimore dhe bimeve mhakesore, import i mallrave ushqimore, lendeve te para, pjese nderrimi dhe linja e objekte per industrine ushqimore. Selia e shoqerise eshte ne Tirane.

Keshilli Mbikqyres perbehet nga :

1. Mimoza Loli
2. Suzana Kalemi
3. Hatixhe Kellezi

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

G J Y Q T A R E

Tirane, me 2-4- 1995

*Mimoza Loli
Suzana Kalemi
Hatixhe Kellezi*

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 21.08.1995, Ministria e Financave, ne baze te ligjit Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" Ministri i Financave, vendosi :

1. Te krijoj shoqerine anonime " Alimpeksi" Tirane

.Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jetet: Eksporti i mallrave industriale ushqimore dhe bimeve mjekesore,import i mallrave ushqimore,lendeve te para, pjese nderrimi dhe linja e objekte per industrine ushqimore.

3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Tirane dhe ajo mund te cele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.

4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 209.950.000 leke, nga kjo vlera e truallit 3.785.040 leke Nr. i aksioneve 209.950.

5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.

6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :

1. Mimoza Loli

2. Suzana Kalemi

3. Hatixhe Kellezi

7.Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitive te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themelues.

DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE

BERZH PIRANIAN

S T A T U T

I SHOQERISE ANONIME

Ne baze te dispozitave te ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", me autorizim te Ministrit te Financave, Z. Berzh Piranian, Drejtor i Drejtorese te Shoqerive Publike nenshkruan statutin e shoqerise anonime si me poshte :

Neni 1

Shoqeria anonime formohet nga transformimi i ish ndermarrjes shteterore Alimpeksi Tirane.

Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet Sh.A. "Alimpeksi" Tirane.
Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranes.

Neni 2

Objekti i shoqerise eshte :Eksporti i mallrave industriale,ushqimore dhe bimeve mjekesore,import i mallrave ushqimore, lendeve te para, pjese nderrimi dhe linja e objekte per industrine ushqimore.

Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe finanziar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e sipermarrjeve te tjera dhe pjesemarrjen ne sipermarrje te tjera si brenda, ashtu edhe jashte vendit.

Neni 3

Kapitali themeltar-akcionet

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 209.950.000 leke, nga kjo vlera e truallit 3.785.040 leke. Nr.i aksioneve 209950.

Vlera nominale e aksionit eshte 1.000 leke.



Neni 4

Shitja e aksioneve ne rastin e privatizimit.

Aksionet e shoqerise mund t'u shiten personave fizike e juridike shqiptare vetem ne rastin e nje vendimi te marre nga Ministri i Financave per privatizimin e shoqerise nepermjet bonove te privatizimit dhe/ose lekeve te privatizimit.

Personat e huaj, fizike a juridike, mund te blejne aksione te shoqerise vetem ne rastet dhe ne masen e caktuar nga Ministri i Financave. Shlyerja e aksioneve nga personat e huaj, fizike a juridike, behet vetem me para ose me anen e kontributeve ne natyre per qellime teknologjike.

Neni 5

Organet drejtuese

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Keshilli mbikqyres.
2. Drejtori i per gjithshem

Neni 6

Keshilli mbikqyres

I. Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 anetare.

Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen :

2/3 nga Ministri i Financave

1/3 nga Ministri i Bujqesise dhe Ushqimit

II. Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithe te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar vetem per shkaqe te perligjura.

III. Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesar ne shoqeri.

IV. Nese nje ose disa vende te anetareve te keshillit te mbikqyrjes mbeten bosh per shkak vdekjeje, shkarkimi ose doreheqjeje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se tre muaj.

Anetari i keshillit mbikqyres, i emeruar ne zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit.

V. Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te bejne pjese ne me shume se tre keshilla mbikeqyres te shoqerive anonime qe e kane seline ne territorin e Republikes se Shqiperise.

VI. Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 vjeç nuk mund te jene me shume se nje e treta e numrit te per gjithshem ne mbyllje te ushtrimit te çdo viti finanziar. Nese kjo perqindje tejkaloitet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

Neni 7

Kryetari dhe zevendeskryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendeskrytar, te cilet ngarkohen te mbledhin keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata emerohen per te gjithe kohen e mandatit te tyre ne keshillin mbikqyres dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te emeroje nje sekretar jashte anetareve te tij.

Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit mbledhjet e e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendeskryetari.

Neni 8 Vendimet e keshillit

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interes i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendeskryetarit.

Kryetari duhet te therrase keshillin mbikqyres, brenda pesembedhjete diteve, kur drejtori ose nje e treta e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitim atij nje kerkese te motivuar per kete qellim.

Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere autoret e saj mund te therrasin keshillin, duke i permendur rendin e dites.

Ne parim thirrja duhet te behet tre dite perpara, me leter, telegram, teleks ose telefaks. Por ajo mund te behet me goje dhe pa afat ne qofte se anetaret e keshillit mbikqyres e pranojne ate.

Çdo thirrje duhet te tregoje çeshtjet kryesore te rendit te dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres behet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

II. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem, ne qofte se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te keshillit.

Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne rast votash te barabarta, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

III. Keshilli mbikqyres mban nje register te pjesemarrjes ne mbledhjet e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje.

IV. Vendimet e keshillit mbikqyres evidencohen me procesverbale te hartuara ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari i seances dhe nga nje anetar i keshillit ose, ne mungese te kryetarit, nga jo me pak se dy anetare te keshillit.

Kopjet e ketyre procesverbaleve vertetohen nga kryetari keshillit mbikqyres, zevendeskryetari dhe nga drejtori i per gjithshem.

Neni 9

Kompetencat e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te per hershem per administrimin e shoqerise nga drejtori i per gjithshem i saj dhe i jep ketij te fundit autorizimin paraprak per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtori i per gjithshem pa autorizimin paraprak te keshillit mbikqyres.

Keshilli mbikqyres emeron drejtorin e per gjithshem.

Ai autorizon marreveshjet e parashikuara ne nenin 13 te ketij statuti.

Ai autorizon drejtorin e per gjithshem te kryeje veprimet dhe te marre masat e parashikuara ne nenin 12 te ketij statuti.

Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontolle qe ai i çmon te pershtatshme, dhe kerkon te njihet me dokumentet qe ai i gjykon te nevojshme per perm bushjen e detyres se tij.

Drejtori i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj.

Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar, drejtori duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli i tyre nga ky i fundit.

Keshilli mbikqyres shqyrton llogarite vjetore dhe reportin vjetor te paraqitur nga drejtori i per gjithhem dhe i paraqit per kete nje raport Drejtorise te Shoqerive Publike.

Keshilli mbikqyres mund t'i ngarkoje njerit ose disa anetareve te tij çdo mandat te posaçem per nje ose disa objekte te caktuara.

Neni 10

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres.

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.348 date 3.7.1995 "Per keshillat mbikqyres te shoqerive shteterore".

Masa e shperblimit caktohet nga aksionmbajtesi i vetem.

Neni 11

Drejtori i per gjithhem

I. Drejtori i per gjithhem emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pak se 3/4 e anetareve te ketij keshilli. Ai mund te zgjidhet qofte ndermjet personave te shoqerise, qofte edhe jashte te punesuarve te saj.

Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet drejtor, mandati i tij ne keshill merr fund me hyrjen e tij ne funksion.

Nje person nuk mund te emerohet drejtor ne me shume se nje shoqeri.

Drejtori mund te shkarkohet nga keshilli mbikqyres vetem per shkak te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur nje kontrate punesimi me shoqerine,

shkarkimi i tij nga funksioni i drejtorit nuk eshte shkak per zgjidhjen e kesaj kontrate.

II. Drejtori emerohet per nje periudhe kohe prej 4 vjetesh. Ne rastet te pushimeve dhe te mungesave te tjera te zgjatura, keshilli mbikqyres ben menjehere zevendesimin e tij.

Drejtori eshte i riemerueshem. Ai nuk mund te jetë ne moshen mbi 65 vjeç.

Drejtori qe mbush 65 vjeç, quhet zyrtarisht i shkarkuar dhe zevendesohet menjehere.

Menyra dhe masa e shperblimit te drejtorit caktohen nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tij.

Neni 12 **Kompetencat e drejtorit**

I. Drejtori ka kompetenca te plota ndaj te treteve per te vepruar ne emer te shoqerise ne çfaredo trethane, me perjashtim te kompetencave qe i jane caktuar shprehimisht keshillit mbikqyres nga ligji dhe nga ky statut.

Ne marredhenie me te tretet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise, perveç rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorit kapercente objektin e shoqerise dhe vepron te keqbesim, ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt, duke pasur parasysh faktin se vete shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.


Kufizimet e kompetencave te drejtorit te caktuara ne statut duhet te respektohen nga te tretet.

Megjithate, ne cilesine e masave te rregullimeve te brendshme te shoqerise, por qe nuk u kundervihet te treteve, veprimet dhe masat e meposhtme kryhen vetem me autorizim te keshillit mbikqyres:

- percaktimi dhe ndryshimi i programit te veprimtarise afatshkurter,

afatmesem dhe afatgjate te shoqerise;

- kryerja e investimeve dhe financimeve per vitin finanziar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e buxhetit fillestar te shoqerise;



A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized 'W' or similar mark, followed by the number '6' at the bottom right.

- hapja e veprimtarive ose e njesive te reja, shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja teresisht a pjeserisht e veprimtarive dhe njesive te shoqerise;
- blerja, shkembimi dhe shitja e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise;
- themelimi i shoqerive ose pjesemarrja ne shoqeri te tjera te krijuara, ose per tu' krijuar;
- marrja e huave afatmesem, afatgjate, dhenia e dorezanive ose e garancive te tjera kur keto te fundit tejkalojne veprimtarite e zakonshme te shoqerise;
- negocimi, perfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 3 vjet ose per nje shume detyrimesh vjetore mbi dy milione leke;
- percaktimi i kritereve per diskutimin, perfundimin dhe ndryshimin e kontrates se punesimit me punonjesit;
- ne per gjithesi marrja e vendimeve dhe masave qe e kapercejne veprimtarine e zakonshme te shoqerise dhe qe jane te tilla qe mund te sjellin ndryshime ne objektin e shoqerise.

II. Drejtori i per gjithshem mund te delegoje nje pjese te kompetencave te tij, qe ai i gjykon te dobishme tek nje ose disa persona te tjere qe kryejne funksione teknike ne drejtimin e shoqerise.

III. Drejtori i per gjithshem perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet.

Emerimi dhe pushimi i tij duhet te publikohet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Aktet, me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve, duhet te mbajne nenshkrimin e drejtorit te per gjithshem, ose te personit te autorizuar rregullisht nga drejtori per keto akte.

Neni 13

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe drejtorit ose nje anetari te keshillit mbikqyres

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe drejtorit te per gjithshem ose nje anetari te keshillit mbikqyres, qofte e drejtperdrejte ose jo e drejtperdrejte, duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Kjo dispozite eshte e zbatueshme edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nje anetar i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i

Neni 17

Rezultati i ushtrimit dhe caktimi i fitimeve

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diferenca ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire te keto te fundit amortizimet dhe provisionet.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuara, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, hiqen te pakten 5 per qind per te krijuar rezerven e domosdoshme.

Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin nje te dhjeten e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye çfardo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen nje te dhjeten e kapitalit.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, shoqeria do te heqe jo me shume se 85 per qind per krijimin e rezerves per zhvillim.

Shuma e fitimeve te mbetur pas heqjeve per krijimin e rezervave te permendura me siper perfaqeson dividentin, i cili derdhet ne buxhetin e shtetit.

Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zvogelimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk behet asnjë heqje dhe asnjë derdhje dividenti, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per t'u perfshire ne fitimet e ushtrimeve te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Caktimi (shperndarja) e fitimeve dhe menyra e mbulimit te humbjeve behen me vendim te Ministrit te Financave me cilesine e tij si aksionmbajtes i vetem ne shoqeri.

Neni 18

Emerimi i anetareve te pare te Keshillit Mbikqyres.

Si anetare te pare te Keshillit Mbikqyres emerohen :

1. Mimoza Loli banues ne Tirane
2. Suzana Kalemi banues ne Tirane
3. Hatixhe Kellezi banues ne Tirane

Neni 19

Te gjitha atributet e asamblese se per gjithshme te parashikuara nga ligji Nr.7638 date 19.11.1992 qe nuk jane shprehur ne kete statut do te ushtrohen nga Ministri i Financave me cilesine e aksionmbajtesit te shtetit ne shoqeri.

Neni 20

Emerimi dhe shkarkimi i drejtorit te pare

Ne nje afat prej 6 muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise drejtori i ish ndermarjes shteterore do te jete i emeruar zyrtarisht Drejtor i per gjithshem i Shoqerise dhe do te jete per gjeqjes per ruajtjen e pasurise te saj.

Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet vetem nga Ministri i Financave dhe per shkaqe te perligjura mbi bazen e propozimeve te Drejtorise te Shoqerive Publike ose te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise.

Hartuar ne Tirane me 3 gusht 1995 ne 6 kopje te njejtë.

DREJTORI I DREJTORISE TE SHOQERIVE PUBLIKE

BERZH PIRANIAN

